



ANALIZA VJETORE

VITIT

2010

Janar 2011

Të nderuar pjesëmarrës !

Ne takimin e sotem kemi si qellim te rikthejme ne kujtesen tone, objektivat e parashikuara per vitin 2010, realizimin e tyre dhe problemet qe jane evidentuan ne punen 12 mujore te vitit qe sapo mbyllem.

Viti 2010 ka qene nje vit pune dhe angazhimi nga çdo punonjes i administrates se Bashkise, dhe gjithë faktoreve bashkepunues, per te perballuar detyrat funksionale te fokusuara ne keto drejtime kryesore :

- a. Realizimin e te ardhurave te planifikuara, per te mundesuar veprimatrine ekonomike te Bashkise;
- b. Mbajtjen nen kontroll te shpenzimeve buxhetore, per te qene koherent ndaj situates ekonomike dhe krizes financiare globale;
- c. Per te mundesuar zbatimin optimal te programit te parashikuar, ne investimet publike, per permiresimin e infrastruktures;
- d. Ndjekja ne vazhdimesi te programeve te zhvillimit perspektiv te qytetit si rivleresimi i Strategjiese se Zhvillimit Ekonomik dhe Social te Bashkise, Plani i Pergjitheshem Rregullues, klasifikimi i projekteve te zhvillimit per Parkun Industrial te qytetit,
- e. Permiresimin e vazhdueshem te cilesise se sherbimeve ndaj komunitetit, si nepermes rritjes se cilesise se punes nga sektoret kryesore dhe gjithëperfshires siç jane; pastrimi, gjelberimi, sherbimi i dekorit & ai funeral;
- f. Ritja e performances se administrates Bashkise ne sherbimet direkte ndaj qytetareve, nepermes takimeve, kerkesave, ankesave etj.

Keto dhe te tjera aspekte, kane qene drejtimet kryesore rreth te cileve eshte punuar nga administrata e bashkise Lezhe, per vitin 2010.

Viti qe sapo mbyllem ka qene një vit i veçante i cili do mbetet ne kujtesen e banorëve lezhjan dhe mbarë shqiptareve, per faktin se :

- Perballuam ndikimin e nje krize ekonomike mbarëboterore, krize e cila ka patur ndikimin e saj edhe ne ekonomine shqiptare, perfshire edhe Bashkine e Lezhes,
- Viti 2010 mund te evidentohet si viti me krizen institucionale me te zgjatur ne 20 vitet e demokracise, ku dy forcat kryesore politike nuk arriten ne kompromise, per miratimin e nje sere ligjesh me rendesi, per reformat institucionale ne vend.
- Njekohësisht viti 2010 do mbetet ne kujtesen e shqiptarëve si viti i aspiratave te shumepritura, per levizjen e lire ne vendet e europes;
- Ne fokusin lokal viti qe sapo mbyllem mund te evidentohet si viti i investimeve publike, nder te cilet mund te evidentojme :
 - a. Fillimin e punimeve per ndertimin e Gjimnazit te ri dhe shkolles 9 vjeçare te qytetit me fondin e akorduar nga BB ne vleren rreth 360 milion \$ (amerikan).
 - b. Rikonstruksioni dhe asfaltimi i rruges lagje “Nene Tereza”;
 - c. Rikonstruksioni dhe asfaltimi i rruges lagje “Skenderbeg”;

- d. Performanca ekonomike e Bashkise ne vite, mundesoj besueshmerine e Bankes Reiffeisen, per akordimin e nje kredie, prej 120 milion leke, me te cilet do realizohen investime me vlere publike ne infrastrukture etj.

Por, cilët kane qëne drejtimet kryesore të punës tonë për vitin 2010 dhe si janë realizuar ata ?!

Ne administraten e bashkise gjate vitit 2011 kane funksionuar 9 drejtori dhe 5 sektorë me nje administrate prej 61 veta, pa perfshire ketu institucionet vartese (6 te tilla me 73 punonjes) dhe funksionet e deleguara (3 sektor me 17 punonjes).

Ne gjithe aktivitetin njëvjeçar te administrates eshte punuar me objektiva konkrete, me detyra afatshkurter dhe afatmesem, per te realizuar detyrat e vitit dhe per te vendosur premisa te sigurta, per nje pune ne vazhdimësi.

Ne kete aspekt mund te evidentojme punen e vitit 2010 sipas drejtorive dhe sektorëve si me poshtë :

DREJTORIA E TE ARDHURAVE :

Ka patur si mision kryesor :

1. Organizimin dhe drejtimin e punes objekt i ligjit 9632 date 30.10.2006 “Per Sistemin e Taksave Vendore”, per realizimin e te ardhurave nga subjektet private te ndodhura brënda juridiksionit të bashkisë, sipas paketes fiskale miratuar nga Keshilli i Bashkise;
2. Regjistrimin e vazhdueshem dhe menaxhimin e subjekteve të tatueshme, ndjekjen e politikave programore dhe strategjitë implementuese mbi licencimin e rrjetit të biznesit në qytetin e Lezhës ne veprimtarine gjithëvjete;
3. Krijimin e database për licensimin e të gjitha subjekteve tregtare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin e Lezhës te regjistruara ne organet tatimore;
4. Ushtrimin e kontrolleve efikase ne rrjetin e tregëtisë se qytetit me objekt realizimin e te ardhurave fiskale, planifikuar per vitin 2010.

Si jane realizuar detyrat e vitit 2010 nga kjo drejtori :

Në zbatim te ligjit “Për sistemin e taksave vendore” dhe vendimin e Keshillit Bashkise 28.12.2009 “ Për miratimin e nivelit të taksave e tarifave vendore të vitit 2010” ne punen e drejtorise se taksave & tarifave vendore ka dominuar tendenca, per bashkepunim te panderprere me taksapaguesit lezhjan per realizimin e te ardhurave ne funksion te buxhetit te vitit 2010, ndonese veshtiresite ne arketimin dhe realizimin e te ardhurave ne nje situatë krize globale, nuk kanë qene të lehta.

Per vitin 2010 kemi patur te planifikuara **174 938 mije leke** te ardhura, nga te cilat jane realizuar **127 33 mije lekë** ose **72.79 %** me nje diference mosrealizimi prej **47 598 mije lekë**.

Burim i te ardhurave kane qene 993 subjekte biznesi.

Te ardhurat e vitit 2010 jane realizuar ne keto nivele :

a. Nga taksat vendore:

1. Taksa e biznesit te vogel nga subjektet tregetatre dhe ato te transportit, planifikuar 33 262 mije leke, realizuar 24 166 mije leke ose 72,65 %, duke patur parasysh se mosrealizimi ka patur si faktor kalimin e subjekteve ne biznes te madh ne shumen absolute prej 3 751 mije leke ose 11,28 % e shumes se te ardhurave planifikuara;
2. Taksa mbi pasurine e paluajtshme, planifikuar 8 350 mije leke, realizuar 5. 442 mije leke ose 65,17 %;
3. Taksa e kalimit te pronsise me agjent tatimor ZRrPP-ne e planifikuar 7.500 mije leke, u realizu ne masen 1 865 mije leke ne masen 24,87 %, me nje diference prej 5.635 mije leke. Ky tregues ka patyur ndikimin e krizes globale, nga ulja e trasnaksionet per kalim ne regjistrin e pronesise.
4. Taksa e tabelës dhe reklames, planifikuar 1 837 mije leke, realizuar 2 396 mije leke ose 130,4 % etj.

b. Nga tarifat vendore:

Te ardhurat ne total u realizuan ne shumen 31.472 mije leke nga 58.380 mije leke te planifikuara ose 56,50 %. Theksojme se ndikimin ne mosrealizimin e te ardhurave nga tarifat vendore erdhen si rrjedhoje e mosrealizimit ne shumen prej 25 milion leke ne te ardhurat e planifikuara nga ALUIZNI.

1. Tarifa e pastrimit dhe largimit te mbeturinave, planifikuar 10 milion leke, u realizuan 7.252 mije leke ose 72,52 %. Diference kjo prej 2.748 mije leke, e cila ka patur si arsye mosrealizimin e arketimit te te ardhurave nga tarifa e pasatrimite e abonenteve familjare, biznese debitore dhe informale.;
2. Te ardhura te tjera, planifikuar 32.958 mije leke, realizuar 11.555 mije leke ose 35,06 %.

Mangesite qe sollen mosrealizimin e te ardhurave per vitin 2010 rezultojne te jene subjektive dhe objektive, nder te cilat evidentojme :

a. Aresyet subjektive :

1. Mangesi te drejtorise tatim – Taksave ne aspektin e realizimit te objektiveve.Kembengulje ne zbatim te ligjit, pavaresisht nga kundershite e perditeshme, me te cilat eshte ndeshur sektori i taksave dhe tarifave vendore;
2. Mangesi ne sensibilizimin e komunitetit te biznesit, nga specialistet e sektorit te taksave dhe policia bashkiake;
3. Mungese bashkepunimi nga sektori i taksave me drejtori dhe zyrat homologe ne bashki;
4. Mangesi ne bashkepunimin e sektorit tatim- taksave te Bashkise me Drejtorine Rajonale te Tatim Taksave;

b. Aresyet objektive :

1. Kalimi ne biznes te madh te 31 subjeteve te qytetit, pas miratimit te buxhetit vitit 2010, solli nje ndikim prej 3.751 mije leke ne mosrealizimin e te ardhurave;

2. Mbyllja e 180 subjekteve nga te cilat 111 u mbyllen nga QKR-ja dhe 69 te tjera kane nderprere aktivitetin, per arsye falimentimi, te cilat sollen nje ndikim prej 4.784 mije leke mosrealizim;
3. Ndryshimi i ligjit, per arketimin e te ardhurave nga legalizimi i banesave, ne interes te buxhetit te shtetit, pati nje pasoje prej 25 milion leke mosrealizim;
4. Mungesa e tradites nga komuniteti qytetar, ne aspektin e likujdimit te tarifes se pastrimit dhe heqjes se mbeturinave, solli nje mosrealim prej 2.748 mije leke.

DREJTORIA E FINANCES :

Ka patur si objektiv kryesore :

1. Ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme te gjendjes financiare dhe ushtrimin e kompetencave ne zbatim te efektivitetit ekonomik dhe drejtimit financiar.
2. Hartimin e treguesve te buxhetit dhe ndjekjen e realizimit te tij, per vitin buxhetor.
3. Ushtrimin e kompetencave ne zbatimin e parimeve të efektivitetit ekonomik dhe drejtimit financiar, me kujdesin që fondet e miratuara të administrohen sa më efektivitet.
4. Ndjekjen ne menyre permanente te situates ekonomike si, realizimin e te ardhurave; shpenzimet, investimet dhe inventarizimin e pasurise, në administraten e bashkise dhe institucionet vartëse etj.

Cilët jane disa nga treguesit financiar kryesor të vitit 2010 :

Planifikuar : 241 150 mije leke; realizuar : 179 569 mije leke ose 74,5 % nga i cili :

- **Fondi i pagave** - planifikuar 61 080 mije leke, realizuar 60 234 mije leke ose 98,6 %.
- **Shpenzime operative** - planifikuar 44 490 mije lekë; realizuar 42 781 mije leke ose 96,2 %.
- **Investimet** - planifikuar 245 584 mije leke; realizuar 183 887 mije leke ose 75 %.
- **Sherbime me kontrate** - planifikuar 33 663 mije leke; realizuar 33 068 mije leke ose 98,2 %.

Disa nga aresyet e mosrealizimeve :

Siç rezulton nga shifrat e buxhetit te paraqitura me siper rezulton qe viti 2010 te ishte nje vit i veshtire financiar, i shoqeruar me mosrealizime ne treguesit kryesor.

Shpenzimet buxhetore ne total, per vitin 2010, u realizuan vetem 74,5 % duke krijuar nje difit buxhetor prej 61.581 mije leke.

Nga tabela e paraqitur me lart verehet se shpenzimet baze ne fondin e pagave dhe sherbimet publike jane realizuar sipas planifikimit.

Realizimi i përafert i shpenzimeve ne zerat e lartpermendur eshte i lidhur me faktin se :

Se pari : Fondi i pagave kushtezohet me strukturen administrative e cila ka qene e plotesuar gjate gjithë vitit;

Se dyti : Shpenzimet ne sherbimet publike jane realizuar, si detyrim ndaj komunitetit dhe ndaj siper marrjeve te kontraktuara.

Mosrealizimi ne investimet publike eshte i lidhura me dy faktor :

Se pari : Investimet e planifikuara nga te ardhurat vendore, kushtezoheshin me nivelin e realizimit te te ardhurave (realizuar vetem 71 %)

Se dyti : Investimet buxhetore, nuk u realizuan plotesisht per aresye te pezullimit te punimeve ne shkollen “Beslidhja”, nga konflikti i pronesise se truallit.

Kemi bindjen se viti buxhetor 2011 do kete nje performance akoma me te mire, si nepermes realizmit ne nje nivel me te larte te te ardhurave vendore, rritjes se grant-it te dhene nga Qeveria.rreth 14,6 % me shume nga viti i kaluar dhe mbeshtetja me Kredi nga Banka Raiffeisen.

DREJTORIA E URBANISTIKES :

Ka patur si objektiv :

1. Organizimin e punës studimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit urban te qytetit harmonizimin e masave konkrete në aspektin e ndyshimeve dhe përmirësimit të Planit Rregullues të qytetit;
2. Ndjekjen dhe bashkërendimin e punës për zbatimin e legjislacionit, në fushën e ndërtimeve, investimeve publike dhe private në territorin e qytetit;
3. Realizimin e strategjive dhe politikave në fushën e urbanistikës, menaxhimin e rregullimit të territorit urban të qytetit.
4. Hartimin e projekteve dhe bashkerendimi me njesite e tjera te bashkise, per realizimin e investimeve publie, ne ndertimin dhe rikonstruksionin e infrastruktures publike.

Nder realizimet e vitit 2010 ne kete drejori evidentojme :

a. Ne aspektin e planifikimit urban:

1. Eshte perfunduar Detyra e Projektimit per fazen permbyllese te Planit Pergjithshem Rregulles te qytetit;
2. Jane hartuar pese detyra projektimi per sistemimin e blloqeve te banimit ne lagjet e respektive;
3. Zbatimin e reformes se ndermarre nga Qeveria shqiptare, per hartimin e nje sistemi funksional dhe modern te adresave dhe referencave gjeografike te sakta ne qytete. Aktualisht kemi te gjitha rruget e qytetit te emertuara me vendim te keshiilit bashkiak.

b. Ne aspektin projektimit dhe investimeve publike:

Eshte synuar ne hartimin e studimeve urbanistike dhe projektet e zbatimit per infrastrukturen publike ne bashkepunim me njesine e Prokurimit Publik, per prokurimin dhe zbatimin e ketyre projekteve. Keshtu u arriten te pergatiten projekte mjaft cilesore, hartuar nga studio serioze te vendit, te cilët kane krijuar mundesine e investimeve ne 12 objekte te rendesishme ne infrastrukturen publike duke perfshire te gjitha lagjet e qytetit, pjesa me e madhe e te cileve kane filluar punimet ose jane ne fazen e prokurimit. Te tjera do prokurohen me miratimin e buxhetit, ne ditet e para te ketij fillimviti.

c. Nder detyrat funksionale te kesaj drejtorie evidentojme :

1. Janë miratuar 42 vendime në mbledhje të KRRR-it se ndër të cilët, 16 detyra projektimi dhe studime urbane dhe 26 leje ndërtimi për objekte publike dhe private.
2. Janë ushtruar kontrole për të gjitha objektet (e pajisura me leje ndërtimi) që janë në ndërtim e sipër, sipas fazave të ndërtimit.
3. Nga sektori i Kadastrës Urbane janë përgatit dosjet për regjistrimin e 20 pronave publike dhe janë në proces planet e riveimit dhe planimetritë e 100 pronave të tjera.
4. Të ardhurat nga ky sektor janë realizuar në masën 97,7 % ose 9,5 milion leke më shumë se vitin 2009.

Nr	Të ardhura		%
	Planifikuar	Realizuar	
1	61 000 000	59 573 878	97,7 %

Nga të dhënat e sipërcituara rezulton se kjo drejtori i ka realizuar, relativisht mirë detyrat e vitit 2010.

Një aspekt i rëndësishëm në punën gjithëvjetore të kësaj drejtorie ka qenë dhe mbetet partneriteti me investitorët privat, krijimin e hapësirave ligjore, për paraqitjen e dokumentacionit teknik të objekteve private, si një mundësi e vetme, për ndërtimin e zonave të reja të qytetit dhe rindërtimin e zonave të tjera urbane. Nga specialistët e kësaj drejtorie janë krijuar raporte të drejta bashkëpunimi me investitorët privat si dhe janë ndjekur të gjitha fazat e ndërtimit të objekteve private që nga pikëtimi deri në lejen e ndërtimit duke nënshkruar aktet e kontrollit në të gjitha fazat.

Ndonese hapësirat për ndërtime të reja në Lezhë nga viti në vit kanë ardhur duke u zvogëluar, me hartimin e Planit Rregullues dhe zgjerimin e zonës urbane të qytetit do krijohen perspektiva të reja, për një qytet gjithnjë në rritje.

Një mundësi më shumë në cilësinë e punës së kësaj drejtorie duhet vlerësuar fakti se struktura e saj ka qenë e plotësuar me një staf kompleks mjaft profesional (i cili këtë vit - 2011 është pak më i cingëruar).

Krahas nivelit profesional në punën e kësaj drejtorie, ka ndikuar edhe trajnimi i zhvilluar me stafin e saj brenda dhe jashtë vendit si nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKTP), USAID, Co – Plan, ITAP etj.

Më krijimin e hapësirave të reja urbane dhe hyrjen në fuqi të ligjit të ri, për planifikimin e territorit, mjaft detyra specifike presin këtë sektor në vitin 2011 e në vijim.

DREJTORIA E NDIHMES EKONOMIKE & PERKUJDESIT SHOQEROR

Ka patur si objektiva kryesor :

1. Evidencimin e familjeve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuara; brenda territorit të bashkisë, për t'u krijuar kushtet e favorshme dhe ofruar ndihmën e nevojshme ekonomike dhe shërbimin e duhur social brenda kuadrit ligjor.
2. Hartimin e programeve të veprimit afatmesëm dhe afatgjatë, në vijim të strategjisë kombëtare, për zbutjen e varfërisë, implementimin e projekteve publike, integrimin e pakicave etj;

3. Bashkëpunimin me shoqata, fondacione dhe sektore homolog, për hartimin e programeve të përbashkëta në ndihmë të individëve dhe familjeve në nevojë, për zbutjen e varferisë.

Në vijim të përvijës së krijuar në vite, stafi i kësaj drejtorie gjatë vitit 2010 krahas detyrës tradicionale të trajtimit të familjeve me ndihmën ekonomike dhe pagesën e paaftesisë, ka treguar një vëmendje të veçantë në implementimin e praktikave të reja në shërbim të individëve dhe familjeve në nevojë, si nëpërmes projekteve të shërbimit në komunitet dhe gjetjen e donatorëve të ndryshëm për bashkëfinancimin e projekteve, për kujdesin social dhe uljen e varferisë, duke patur si prioritet familjet e komunitetit Rom dhe Egjiptian.

Ndër realizimet e vitit 2010 evidentojme :

1. Në sektorin e ndihmës ekonomike detyra kryesore ka qenë ruajtja paster e skemës së ndihmës ekonomike në mbështetje të ligjit 9355 datë 10.3.2005
Gjatë vitit 2010 janë trajtuar mesatarisht me ndihmë ekonomike 546 familje në muaj, me një fond mesatar 2 300 mijë leke.
Në krahasim me vitin 2009 është ulur numri i familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike, për rrjedhojë është rritur edhe masa e ndihmës ekonomike e përfituar për çdo familje, në vlerën 300 – 500 leke në muaj (në varesi të numrit të frymëve).

<i>Nr.</i>	<i>Lagja</i>	<i>Familje</i>
1	Skenderbeg	247
2	Besdlihdhja	103
3	Varosh	125
4	Nene Tereza	71
	<i>Gjithsej</i>	<i>546</i>

2. Kushtëzimi i ndihmës ekonomike me ***“Punëve dhe shërbimeve në komunitet”***, ka qenë detyra tjetër kryesore në mbështetje të ligjit 1053 datë 23.4.2008.
Kjo detyrë për vitin 2010 është konkretizuar për 7 muaj dhe konkretisht, gjatë muajit prill – qershor janë angazhuar përfaqësues të 180 familjeve, ndërsa në muajin tetor – dhjetor 174 përfaqësues të tjerë, të cilët realizuan disa punë me vlera komunitare si; në zonën e Kalasë, në qytetin antik të Lis-it, pastrimin e inerteve dhe sistemimin e rrugës së lagjes etj.
Kjo formë trajtimi jo vetëm që është një kërkese ligjore, por njëkohësisht nëpërmes ***“Punëve dhe shërbimit në komunitet”***, aktivizohen forcat me aktive të kontigjentëve që trajtohen me ndihmë ekonomike, duke i orientuar fondet sociale indirekt në shërbim të gjithë komunitetit.
3. Janë trajtuar me perkrahje sociale 742 persona me aftësi të kufizuara:

<i>Nr.</i>	<i>Emertimi</i>	<i>Gjithsej</i>
1	Paraplegjik	33
2	Te verber	56
3	Invalid pune	407
4	Handikap	246
	<i>Gjithsej</i>	<i>742</i>

4. Nepermes donatorve qe ushtrojne aktivitet ne qytetin e tone eshte mundesuar zbatimi i disa projekteve sociale nga te cilet evidentojme :
- Ngritja e Kampit Veror ne mjediset e fondacionit “Forca e Drites” ne I. Lezhe me pjesemarrjen e 46 femijeve te moshes 8-13 vjeç te familjeve ne nevoje, perfshire edhe femijet e komunitetit Ron dhe Egjiptian;
 - Trajtimin me pako ushqimore te 60 familjeve ne varferi ekstreme, me financime po nga Fondacioni “ Forca e Dritës”, per periudhen prill 2010 – janar 2011.
 - Trajtimi i 162 femijeve lypsare, te braktisur, jetime ose nga familje te divorcuara kryesisht te komunitetit Rom dhe Egjiptian nga Qendra “Shenjetja Mari“, me te cilet krahas trajtimit ekonomik, zhvillohen edhe tema te karakterit edukativ;
 - Ne bashkepunim me Kryqin e Kuq – Lezhë dhe ate Spanjoll. eshte zbatuar projekti – “Kurs rrobaqepësië“ me pjesemarrje te 90 gave e vajzave, nga te cilet 35 perfituesi nga Bashkia Lezhe.

Ç’solli kjo eksperience dy vjeçare ne kete fushe ?.

Tash me, u kriju nje pervoje konkrete dhe bindese se per Bashkine Lezhe eshte jo vetem e mundeshme, por edhe e domosdoshme.

Eksperienca e perfituuar te bind per mundesine ne zgjidhjen e problemeve ne pune e sherbime te d.m.d. te natyrave te lehta – por jo me shume se dy - tre dite ne muaj per çdo person.

Ndihmesa e ketyre forcave persheptuan krijimin e nje rruge kembesore per vizitore qe shkojne ne Kala, e cila tashme funksionon normalisht.

Kryesore eshte ajo qe : çdo familje dhe force e afte per pune detyrimin per te punuar 1-2 dite ne ***“Pune e sherbime ne komunitet“***, tashme e kuptojne dhe vleresojne ndryshe, duke u pajtuar natyrshem me kete detyrim ligjor.

Ne veprimtarine e kesaj drejtorie per vitin 2011 mbetet; rritja e efektivitetit te ndihmes ekonomike duke e harmonizuar ate me projekte te “Puneve dhe sherbimeve ne komunitet” dhe gjetjen e donatoreve, per bashkefinancimin e projekteve sociale, ne mbeshtetje te minoritetit Rom, Egjiptian dhe familjet ne nevoje.

DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE:

Ka patur si objektiva kryesore :

- Ngritjen në nivelin e kërkesave të kohës dhe kulturës qytetare të të gjitha shërbimeve publike, të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e jetës së qytetarit si: në aspektin e

permiresimit të sistemit të pastrimit të qytetit, ruajtjes dhe pasurimit të fondit të gjelbërt në qytet dhe kurorën përreth tij, duke synuar për një qytet të pastër dhe gjithmonë të gjelbëruar;

2. Vlerësimin si aspekt prioritar të raportit dhe kërkesat ndaj sipërmarrjeve private, për realizimin cilësor të shërbimeve të kontraktuara si: pastrimin, gjelbërimin, shërbimin funeral dhe dekorin;
3. Bashkërendimin e punës me faktorë të tjerë të interesuar në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike dhe përfshirjes së banorëve në monitorimin vlerësimin dhe bashkëqeverisjen komunitare, për implementimin e suksesshem të projektit të grumbullimit e trajtimit të diferencuar të mbetjeve urbane.
4. Vlerësimin si detyrë permanente; mirëmbajtjen e institucionet publike, rrjetin rrugor, sistemin e kanalizimeve, sinjalistikën rrugore, rrjetin e ndriçimit publik;
5. Nga inspektoriat i shërbimit veterinar të vendoset rregull në tregun e produkteve me origjinë shtazore dhe peshkut për parandalimin e intoksimeve etj.

Realizimi i përgjegjesive nga kjo drejtori:

Drejtoria e shërbimeve publike si një nga sektoret me të rëndësishëm në qytet gjatë vitit 2010, ka synuar në përmirësimin e shërbimit ndaj komunitetit dhe krijimin e një tradite, për një qytet të pastër.

Nga kërkesa gjithnjë në rritje e specialistëve të kësaj drejtorie dhe angazhimi i sipërmarrjeve private është bërë e mundur realizimi i kontratave në nivele relativisht të mira. Krahas kësaj detyre, një vëmendje e veçantë është kushtuar krijimit të praktikave të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit qytetar, për mirëmbajtjen e infrastrukurës publike, mbrojtjen dhe shtimin e zonave të gjelbëruara, rehabilitimin e blloqeve të banimit etj.

Në sektoret prioritarë është vlerësuar ***shërbimi i pastrimit***, i realizuar me sipërmarrje private “Iridani & Kadeli” i cili ka patur këto shtrirje :

Jane trajtuar rreth 113 mijë m² sipërfaqe pastrimi, rrugë + trotuare;

Jane menaxhuar 75 pika grumbullimi, nga të cilat :

- 14 pika, në qendër të qytetit zbatohet projekti i Ri i menaxhimit të diferencuar të mbetjeve urbane ;
- Në 61 pika të tjera ndodhen 100 konteiner të zakonshëm plastik dhe metalik.

Kjo sipërfaqe pastrimi dhe pikat e grumbullimit të mbetjeve urbane, kanë qenë objekt kontrolli të përditshëm nga specialistët e kësaj drejtorie.

Ky sektor prej dy vitesh po implementon një praktikë të re, për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve urbane, projekt i cili aktualisht ka hyrë në fazë interesante.

Nisur nga fakti se :

- a. Projekti u zbatu vetëm në pjesën qendrore të qytetit;
- b. Ndarja e mbetjeve urbane nuk u realizu plotësisht nga banorët e lagjeve në të cilat filloj zbatimi i këtij projekti;
- c. Mungesa e një qendre për riciklimin e mbetjeve urbane etj.

Keto arsye nxiten në punën e Bashkisë, për gjetjen e donatoreve, për të rifilluar një punë me konkrete në funksion të zbatimit të plotë të këtij projekti.

Keshtu, eshte arritur bashkepunimi me dy donatore te huaj si : Fondacioni Zviceran **dlp** (Intercooperation) dhe ai Hollandez “**Bells**”, me te cilet do te realizohet nje projekt i perbashket me vlere rreth 100 mije Euro, per sensibilizimin e opinionit qytetar dhe ngritjen e nje qendre te ndarjes dhe pergatitjes per riciklim te mbetjeve te ngurta si qelqi, metali, letra etj. Ky projekt i donatore me bashkefinancime nga Bashkia do te mundesoje implementimin e plote te ketij projekti si nder te paret projekte te tilla ne vend. Por, zbatimi i tyre kerkon nje angazhim serioz te drejtorise Sherbimeve Publike, asaj te Programim Zhvillimit dhe sipermarrjes Pastrimit. Me punen e deritanishme dhe trajnimin e stafit qe do merret me projektin ne fjale kushtezohet realizimi i tij.

Krahas zbatimit te ketij projekti dhe gjetjen e mundesive per shtrirjen e ketij projekti edhe ne blloqe te tjera te banimit si dhe permiresimin e punes ne sektorin e pastrimit duhet vleresuar edhe ne disa aspekte te tjera si:

- a. Duhet te mendojme per nje investim te ri, ne mekanizimin dhe permiresimin e praktikes se pastrimit, per “heqjen e fsheses se shqopes” nga perdorimi. Ky mekanizim behet evident per faktin se gjate vitit 2010 investuam ne rikonstruksionin e te gjitha rrugeve te qytetit, perfshire asfaltimin e dy rrugeve te reja. Puna e deritanishme dhe projektet qe do zbatohen gjate vitit 2011, per asfaltimin e rrugeve te tjera krijojne kushte per zbatimin e nje praktike te re pasrimi.
- b. Larja e rrugeve te qytetit duhet planifikuar me shtrirje gjithe vjetore, per vete kushtet e relievit te qytetit tone. E themi kete per faktin se jo vetem ne stinen e veres lind nevoja e larjeve te rrugeve, por edhe ne dimer ku reshjet jane te shumta dhe te shoqeruara me inerte te cilat krijojne ndotje te medha ne qytet.

Keshtu mund te krijojme premisa, per nje “**Qytet te paster**” dhe sherbim me cilesor ndaj komunitetit.

Edhe sherbimi i **Gjelberimit**, realizohet nepermes sipermarrjes private nga shoqeria “Floral”, e cila realizon sherbimin ne nje siperfaqe prej 12.970 m2 zona te gjelberura dhe tapete bari. Ne kete sektor punohet nga sipermarresi me nje pervoje 35 vjecare, sektor i cili ka mjaft permiresime nga viti ne vit i shoqeruar krahas mirembajtjes edhe me investime.

Ne kete sektor eshte rritur niveli dhe cilesia e sherbimit, ndaj gjithe zonave te gjelberuara, ne menyre te vecante ndaj drureve te rinj dekorativ te mbjellura ne dy vitet e fundit.

Krijimi i siperfaqeve te reja te gjelberimit ne blloqet e banimit dhe mbjelljet e reja ne vitet e fundit ka krijuar nje performance cilesore te qytetit.

a. Sektori i Strehimit :

Miratimi i programit 10 vjecar te strehimit nga Keshilli i Bashkise dhe korespondenca e vazhdueshme me MPPT&K dhe Entin Kombetar te Banesave, krijoj mundesine per plotesimin e mareveshjes se Qeverise Shqiptare me BKT-ne, per dhenjen e kredise pa interes te familjeve te pastrehe. Keshtu dy vendimarrje te keshillit bashkise mundesuan miratimin e rreth 200 familjeve te pastrehe te cilat kane aplikuar, si te pastre per t’u trajtuar me kredi. Me kete mase arrihem te veme ne rrugen e zgjidhjes nje nga problemet me te mprehta dhe prej dy dekadave te pazgjidhur. Marrja e kredise nga te pastrehet ne Lezhe

kushtezohet me numrin e madh te apartamenteve te banimit qe ekzistojne ne tregun e banesave.

Nje vend te rendesishem ne punen e drejtorise se Sherbimeve Publike, ka zene sektori i sherbimit **Veterinar**. Nga specialistet e ketij sektori jane realizuar kontrole te perditshme veterinare dhe kryerjen e ekspertizes se mishit qe del ne treg.

Vleresimi i kesaj detyre ka krijuar mundesine per shmangjen e çdo rreziku ne intoksikimin e banoreve, ndonese kete vere kaluan nje stine mjaft te ngrohte.

Edhe **sektori i Sherbimeve** ka patur nje vleresim te vecante, ne punen gjithvjetore te drejtorise sherbimeve. Nga ky sektor jane realizuar sherbimet e nevojshme, per mirembajtjen institucioneve publike ne qytet, rruget, trotuaret, ndricimin e qytetit etj.

Per vitin 2010 nga ky sektor jane kryer sherbime ne vlere material prej 6,69 milion leke, per mirembajtjen e institucioneve dhe infrastructures publike.

Ndonese nga ky sektor detyrat e vitit 2010 jane realizuar relativisht mire, mangesite e konstatuara nuk kane qene te pakta ne praktiken gjithvjetore, nder te cilat evidentojme:

Disiplina e punes dhe intensiteti ne pune ka lene mjaft per te deshruar;

Cilesia e punimeve ne riparimet dhe mirembajtjen e institucioneve nuk ka qene ne lartesine e duhur.

Planifikimi per bazen material qe do perdorej gjate vitit 2010 ka qene me mangesi. Efektet e planifikimit jo serioz sollen mungesa te dukshme ne hartimin e kontrates, per furnizimin me baze material nga operatori I kualifikuar per furnizim.

Mjetet e transportit dhe germimit, jane teje te amortizuara dhe kerkojne sherbime kapitale. Mangesite e konstatuara dhe pretendimet tona gjithnje ne rritje ndaj ketij sektori, duhet te rrisin gamen e pergjegjesise dhe cilesine e drejtimit te ketij sektori nga vete drejtoria e sherbimeve publike.

Disa nga problemet e evidentuara gjate vitit 2010 jane :

- Ne sektorin e pastrimit, krahas permiresimeve te shenuara, pastrimi ne zone e periferise le per te deshruar.
- Promocioni me banoret e qytetit, per bashkepunimin ne mirembajtjen dhe zbatimin e kerkesave qytetare ne sektorin e pastrimit, ndonese eshte kerkese e kontraktuar nuk realizohet nga sipermarrja ne gjithe periudhen gjithvjetore.
- Nga sipermarrja e gjelberimit ne bashkepunim me Inspektoriatin e Ndertimit dhe Policine Bashkiake duhet krijuar nje front i perbashket ne kundervenje ndaj subjekteve qe tentoje te zene hapesirat publike ose te demtojne zonat e gjelberta te qytetit.
- Nga sektori i mjedisit nuk eshte punuar me kembengulje, ndaj subjekteve qe krijojne ndotje te rrugeve dhe zenje te hapesirave publike me inerte si rrjedhoje e ndertimeve ose rikonstruksioneve ne banesa.
- Zgjidhja e problemit te parkimit te autoveturave dhe stabilizimi i trafikut kryesisht ne stinen e veres mbetet evident si problem i pa zgjidhur gjate vitit 2010.

DREJTORIA JURIDIKE & PROKURIMEVE PUBLIKE :

Ka patur si detyre :

1. Të siguroje zbatimin e ligjshmerise ne veprimtarinë e Këshillit të Bashkiak, komisionet e tij, të Kryetarit të Bashkisë dhe administratës, nepërmjete asistencës dhe konsulencës juridike;
2. Të kontrollojë bazueshmërinë ligjore dhe siglojë paraprakisht aktet administrative (urdhra, vendime, urdhëresa) që i paraqiten Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të Bashkisë;
3. Te përfaqësoje institucionin e Bashkise, në proceset gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjykimit kur vendimet e marrura, janë bërë objekt konflikti gjyqësor;
4. Përgatitjen e regjistrit te prokurimeve publike dhe dokumentacionin e prokurimeve publike, per realizimin e investime te miratuara per vitin 2010;
5. Të organizojë dhe mbajë përgjegjësi për funksionimin e punës brenda njësisë së prokurimit, përzgjedhjen e procedurës, zbatimin e afateve etj.

Si jane realizuar detyrat e ketij sektori :

a. Ne sektorin Juridik :

- Ne harkun kohor te vitit 2010, jane ndjekur 9 (nente) procese gjyqesore ku bashkia ka qene pale ose *si person i trete i thirrur nga Gjykata*.
- Eshte punuar ne bashkëpunim me ISAID dhe Co Plan, per *Studimin e Fizibilitetit për Parkun Industrial*.
- Eshte pergatitur dokumentacioni dhe miratuar procedura e privatizimit te 15 banesave, te mbetura pa rregjistruar nga privatizimi i viteve '93 - '94.
- Jane asistuar te gjitha mbledhjet e keshillit bashkise, sipas kerkesave te rregullores dhe raporteve te bashkepunimit Keshill – Administrate e Bashkise;
- Ne rastet e kerkuara eshte dhene konsulenca juridike ne te gjitha drejtorite, si për njohjen e legjislacionit dhe interpretimin e ligjit per rastet konkrete.

b. Nga sektori i Prokurimeve Publike :

Qe ne fillimin e viti 2010 eshte pergatitur Regjistri i Prokurimeve Publike, sipas parashikimeve duke reflektuar ndryshimet sipas buxhetit te miratuar ne keshillin Bashkiak. Me pas eshte pergatitur dokumentacioni per te gjitha prokurimet, si per sherbime, mallra dhe investimet publike.

Nder prokurimet me kryesore mund te permendim :

1. Prokurimin e fondeve te BB-se, per ndertimin dhe supervizionin e dy shkollave te qytetit, te cilat aktualisht jane ne proces ndertimi;
2. Rikonstruksioni i rrugeve kryesore te qytetit.

Ky prokurim i zhvilluar ne kohen e duhur, krijoi mundesine qe investimi te behet ne muajin me te pershtatshem te vitit (muajin korrik);

3. Rikonstruksion i KUZ-ve ne Shetitoren "Gjergj Fishta" dhe rrugen Kosova, investim i cili jo vetem u krye para rikonstruksionit te rrugeve, por njekohesisht mund te konsiderohet si nje faktor qe shpetoi Lezhen nga permbytja tradicionale.
4. "Rikonstruksioni dhe ndricimi i Urës mbi lumin Drin"; "Hidroizolimi i objekteve te arsimit dhe kultures" etj.

Nder angazhimet me te vecanta te sektorit te Prokurimeve Publike, per vitin 2010 mund te evidentojme prokurimin, per "Konkurs Projektimi", ne te cilin u shpall kerkesa, per pergatitjen e projekteve per sistemimi e kater blloqeve kryesore te qytetit, pune e cila kushtezoj fillimin e procedurave per investime themelore me financime nga Kredia e dhene nga Raiffeisen Bank, qe do vijojte me fonde buxhetore dhe nga te ardhurat vendore.

Si rrjedhoje e kesaj zgjidhje mundesoi qe, ne fund te vitit 2010 te shpallen per prokurim disa investime publike nder te cilat evidentojme :

1. "Sistemim i bllokut te banimit ne dy anet e urës mbi lumin Drin - "faza e I-re"
2. "Rikonstruksion rruge dhe sistemim blloku tek shkolla Gjergj Fishta" - "faza II-te"
3. "Sistemim asfaltim rruge lagja "Nene Tereza"- "faze I-re";
4. "Sistemim, asfaltim dhe ndricim rruge tek blloku 11.2 ha, "faza II-te", per te vijuar me prokurimin e investimeve, per "Sistemim asfaltim rruge lagja Spitalit" dhe "Sistemim blloku lagje Gurra".

DREJTORIA E PROGRAMIM ZHVILLIMIT :

Ka patur si objektiv :

1. Monitorimin e realizimeve sipas strategjise së zhvillimit miratuar ne vitin 2005 dhe ripunimin e strategjise se zhvillimit afatshkurtër e afatmesëm në territorin e Bashkise, për vitet 2010 – 2015;
2. Hartimin e indikatorëve te zhvillimit social – ekonomik, duke mbledhurr të dhënat e nevojshme në bashkëpunim me sektorët e drejtoritë e aparatit, per te reflektuar ne strategjine e përgjithshme te zhvillimit dhe ate te turizmit;
3. Hartimin e "Strategjise se zhvillimit te Turizmit" ne qytetin e Lezhes;
4. Ndjekjen e marrëdhënieve me organizma homologe të huaja, fundacione dhe shoqata, te cilat ushtrojne veprimtarine e tyre ne territorin e qytetit ose te vendit tone, në funksion dhe interes të bashkisë;
5. Informimin publik, mbi zhvillimet kryesore social - ekonomike nepermes "Buletinit informativ" periodik, flete palosjeve dhe formave te tjera te komunikimit masiv etj.

Nder realizimet e vitit 2010, por kete sektor evidentojme :

Ripunimi i "Strategjise se Zhvillimit" ka qene prioriteti kryesor i Drejtorise Programim Zhvillimit, per vitin 2010.

Per kete qellim jane organizuar takime te ndryshme me drejtori e specialiste ne aparat, per evidentimin e projekteve te zbatuara nga strategjia e vitit 2005. Ne funksion te saj jane organizuar takime dhe workshope nen drejtimin e FLAG-ut ne kuader te Delta 2.

Nga puna e deritanishme rezulton :

- Te jene evidentuar realizimet nga Strategjia e vitit 2010 dhe hartimi i matricave te projekteve qe do perfshihen ne strategjine e re te zhvillimit 2010 - 2015;
- Jane ngritur grupet e punes qe do pergatisin strategjine;
- Jane realizuar disa konsulta, mbi strukturen e strategjise;
- Eshte konkluduar per Vizionin e Qytetit - **Lezha : Qytet Evropian multituristik me vlera unikale, historike, arkeologjike e etnokulturore; me infrastructure urbane bashkohore, me zhvillim dinamik transporti e agrobiznesi, elemente qe e bejne Lezhen qendren me te rendesishme te Shqiperise Veriperendimore**
- Eshte ne pergatitje materiali qe do trajtohet per miratim ne Keshillin e Bashkise.

Krahas rivleresimit te “Strategjise se Zhvillimit”, nje rendesi te konsiderueshme eshte kushtuar raportit me partneret e Huaj ne teresine e tyre “Marredheniet me Jashte“. Keshtu sjellim ndermend vizitat dhe takimet e realizuara nga perfaqesues te Bashkise ose ne bashkepunim me Keshillin Bashkiake, siç kane qene :

1. Takimet e organizuar ne te gjithë komunat dhe rajonet e Italisë Jugore;
2. Vizita e realizuar ne Dhomen e Tregtise Helenike, ne Athine;
3. Ndjekja e projekteve me partneret dhe konkretisht – projekti per shendetesine me Komunen Leverano;
4. Partneriteti me komunen Vicenza dhe Ancona;
5. Jane hartuar e prezantuar disa projekte ne interese te perpunimit te diferencuar te mbetjeve urbane me Fondacionin **dldp** dhe **bells**.
6. Bashkia jone ishte pjesemarrrese ne Panairin e komunave e bashkive, per “Praktikat me te Mira“, ne te cilen morem vleresim maksimal.
7. Pjesemarrrese ne Panairin per zhvillimin e Turizmit, organizuar ne Lugano – Zvicer. Ne kete panair arritem te prezantohemi mire, ku stendat tona dhe botimet e prezantuara paraqiten interesë per vizitoret.

Nje pune e kujdeseshme eshte bere nga kjo drejtori ne bashkepunim me sektoret e tjere te administrates bashkise, per pergatitjen botimin dhe shperndarjen e **buletinit informativ**.

Te tille ne vitin 2010 jane botuar **kater numra**, ne te cilin jane pasqyruar objektivat, treguesit ekonomik, ato fiskal, investimet dhe ne teresi pervoja e punes se bashkise.

Ky material informativ dhe *Flete –Palosje-t* e pergatitura nga drejtoria e Tatimeve, kane sherbyer jo vetem per transparencen e punes se bashkise, njekohesisht ka krijuar nje lidhje korelative administrate – komunitet.

Me pervojen e vitit 2010, duke njohur mangesite dhe veshtiresite subjektive qe drejtoria Programim – Zhvillimit ka patur, per botimin e materialeve informative, viti 2011 kerkon me shume perkujdesje, transparence dhe komunikim me qytetaret.

DREJTORIA E ARSIMIT, TURIZMIT, KULTURES & SPORTEVE

Ka patur si objektiv :

1. Të sigurojë raporte partneriteti dhe marrëdhënie efektive me gjithë faktorët bashkëpunues në shërbim të ngritjes së cilësisë në sektorin e arsimit, kulturës, turizmit dhe sporteve;
2. Bashkëpunimin me interesa reciproke, me sektorë drejtori, komunitet biznesi, stafet e kulturës e sporteve me fondacione dhe OJF, në funksion të rritjes së cilësisë dhe implementimit të projekteve të zhvillimit në këto sektorë;
3. Koordinimin e punës me institucione shkencore dhe subjekte të interesuara, për një punë shkencore permanente në evidentimin dhe propagandimin e vlerave historike e arkeologjike të zbuluara dhe që do zbulohen në të ardhmen, për qytetin antik të Lis-it.

Niveli i realizimit :

Gjate vitit 2010 kjo drejtori ka qenë e kompletuar me personelin e saj të nevojshëm dhe si e tillë është karakterizuar nga një angazhim me seriozi në të gjithë sektoret e saj.

Plotesimi i strukture me kombinime përvojash, ka krijuar premisa që kjo drejtori të ndjehet me me përgjegjësi veprimtarite e sektoreve të saj.

Kështu mund të evidentojmë se :

Në **sektorin e arsimit** ka patur një vlerësim maksimal, për mirëmbajtjen dhe plotesimin e nevojave të shkollave, për të mundësuar zhvillimin normal të procesit mësimor. Krahas formalitetit është vlerësuar edhe niveli i mesimdhënies, puna me nxënësit me prirje e talente dhe stimulimi i tyre. Këtë vit me vendim të Këshillit Bashkisë u stimuluan 7 nxënës cilësorë të shkollës mesme, të cilët do jenë pikë referimi, për kontingjente që vijojnë.

Sektori i **kultures** e ka përmbushur aktivitetin e tij nëpërmes tre institucioneve si; Pallati i Kulturës, Biblioteka dhe Mezeu.

Këto institucione kanë patur angazhimet dhe mungesitë e veta në periudhën 12 mujore të vitit 2010 ndër të cilat janë :

Pallati i Kulturës i cili mbart peshën kryesore të veprimtarive kulturore dhe artistike në qytet, i cili për vitin 2010 ka realizuar 47 veprimtari, mesatarisht 4 në çdo muaj me një pjesëmarrje rreth 23 mijë spektatore. Këto veprimtari kanë patur edhe karakter tradicional siç janë aktivitetet festive në data të caktuara duke filluar nga 17 janari deri në natën festive të vitit të Ri. Por, e veçanta e vitit 2010 konsiston në ato veprimtari të reja të cilat kanë pasuruar jetën kulturore dhe artistike të banorëve lezhjan, siç kanë qenë :

- Festivali Rinor i “Kenges Magjike - 2010”
- ”Netet e Bardha të Kulturës Shqiptare”.
- Cirku me artistet nga Maqedonia.
- Festivali Folklorik “Shega Lezhjane”;
- Veprimtarite në kuadrin e 100-vjetorit të lindjes së Nënë Terezës etj.

Ndërsa **Biblioteka** e qytetit sipas traditës në vite, po kthehet në një qendër kulturore me përmasa dhe vlera rajonale. Kjo vërtetohet me faktin se mjaft veprimtari kulturore e promovuese të rrethit Mirditë dhe Kurbin e gjejnë vëhten mjaft komodë e të perfillur nga intelektual dhe lexues lezhjan në bibliotekën tonë.

Gjate vitit 2010 nga punonjësit e kësaj institucioni janë kryer 36 000 shërbime të ndryshme, ndër të cilat evidentojmë – janë huazuar 18 500 libra, për lexim në salla dhe shtëpi; me një

ritem ditor nga 90 – 110 lexues. Gjithashtu jane zhvilluar 32 veprimtari kulturore, nder te cilat 15 promovime dhe diskutime krijuese me rreth 1500 pjesemarres etj.

Sektori i **Muzeut dhe Memorialit**, ndonese pa muze, vitin e shkuar ka bere perpjekje, per te nxjerr fondin muzeal nga mbyllja shume vjeçare, per ta bere pjeserisht te vizitueshem.

Një vlëresim te konsiderueshem merr ky sektor ne aspektin e bashkëpunimit me ekspeditat arkeologjike qe janë realizuar vitet e fundit ne qytetin Antic dhe Qafen e Kalase dhe vizitat ne Memorialin e Skenderbeut, si te tilla per vitin 2010 jane regjistruar 7000 vizita, nder te cilat rreth 60 % nga moshat e reja.

Sektori i Turizmit, krahas natyres se përhërshme gjate vitit 2010 ka patur si objeksion kryesor bashkëpunimin si brënda Bashkise dhe partner te tjera, per mbledhjen e te dhenave, per hartimin e “Strategjise se Turizmit”. Gjithashtu evidentojme veprimtarite disas ditore te zhvilluara ne bashkëpunim me Universitetin Italin te Turizmit, me emertimin “*Netet e Bardha te Kultures Shqiptare*”. Kjo veprimtari nuk sherbeu vetem per promovimin e vlërave turistike te qytetit te Lezhes, por edhe **si nje pervoje e re** e cila mund dhe duhet te thellohet ne vite.

Sektori i Sportit, ndonese ne traditen e viteve te fundit rezultatet kane qene me te prekshme ne sektorin “Shumësportesh”, me marrjen e “Presidences se re” te futbollit cilesia sportive po vjen tek ekipi i “Beslidhjes”, shprehur kjo me rezultatet e fundvitit 2010 dhe fillimin e ketij viti. Gjithashtu evidentojme faktin se krahas sporteve tradicioanle si Mundja, Çiklizmi dhe Atletika, performance te mire po bejne ekipet e rinj te Boksit, Karate-se, Xhudo-s etj.

Pa mahuar interesin per sportet e tradites, mendoj se vemendja duhet perqendruar tek sportet e reja dhe levizja masive “Sporti per te gjithë” edhe per faktin se masivizimi sjell cilësi.

Nder problemet kryesore te evidentuara ne kete sektor jane :

1. Ndonese me ndertimin e dy shkollave te reja dhe rikonstrukcionin e shkolles Kosova, arsimi merr nje vlerësim maksimal, gjendja teje e amortizuar ne dy shkollat e tjera “Gj. Fishta” dhe “Gj. Kastrioti” kerkojne zgjidhje afatshkurter.
2. Pallati i Kultures çdo dite e me shume po e humbet funksionin e tij nga amortizimi qe ka patur ne vite.
3. Rikonstrukcioni i Bibliotekes dhe vendosja e internetit eshte bere kerkese e dites.
4. Krijimi i terreneve sportive ne shkolla dhe paisja me baze se nevojshme materiale te ambjenteve sportive ne Klubin e Sportit, jane kerkese e kohes, per rritjen e masivizimit dhe cilesise sportive.

DREJTORIA BURIMEVE NJEREZORE:

Ka synuar :

1. Ne plotesimin e kerkesave baze te punonjesve te aparatit te Bashkise dhe institucioneve vartese, per te mundesuar veprimtarine normale te punes.

2. Ofrimin e punës së administratës së bashkisë me legjislacionin, politikat lokale e rajonale dhe zbatimin e vendimeve të kryetarit dhe Këshillit të Bashkisë ne veprimatrine e çdo punonjesi.
3. Evidentimin dhe venja ne rrugen e zgjidhjes te problemeve qe jane ngritur nga qytetaret, me gojë ose me shkrim.
4. Prezantimin ne media lokale dhe kombetare te arritjeve dhe problemeve qe jane evidentuar ne punen e Bashkise , insitucionet e tjera publike, ne interes te komunitetit lezhjan.

Disa nga realizimet e kesaj drejtorie evidentojme :

- Jane plotesuar te gjitha nevojat themelore, per mbarëvajtjen e punes se çdo drejtorie duke filluar nga personeli i kualifikuar, paisje dhe kancelari.
- Nga sektori i personelit eshte plotesuar rregjistri themeltar dhe jane evidentuar te gjitha dosjet personale te punonjesve.
- Jane hartuar kontratat e punes per gjithe punonjesit e administrates dhe institucioneve vartese.
- Eshte paraqitur ne Keshillin e Bashkise me analize te veçante e gjithë problematika e personelit dhe po punohet per plotesimin e mangesive te trashguara ne vite.
- Eshte pergatitur dhe miratuar ne keshillin e Bashkise “Rregullorja e Brendshme e Administrates”, me pas botuar e paisur zyrat me rregulloren e re.
- Ne bashkepunim me institucione vendase dhe te huaja si; Instituti i trajnimeve te Administrates Publike (ITAP), OSBE, USAID; Partneret – Shqiperi; Co-Plan; GTZ; dldp (Intercooperation), jane organizuar trajnime me punonjesit e sektoreve te ndryshem, sipas profesioneve, grup moshave dhe gjinise si brenda dhe jashte vendit.
- Nga sektori i maredhenjeve me media-n jane dhene rreth 180 kronika televizive ne televizionin publik shqiptare, pa llogaritur qindra kronika, intervista dhe komente te dhena ne tre media-t lokale.
- Nga sektori i arkivit eshte mundesuar sistemimi dhe dorezimi ne arkivin e qarkut i dokumentacionit te kater viteve 1996 -1999 dhe eshte ne proces ai i vitit 2000.
- Nga sektori i maredhenjeve me publikun jane organizuar pritje ditore dhe periodike, per problemet te ndryshme si, per strehim, punesim, ndihme ekonomike, sherbime publike etj. Nga te dhenat e meposhtme rezulton te jete shenuar nje renje ne numrin e kerkesave dhe ankesave nga banoret ne raport me nje vit me pare, perjashtuar ate te strehimit nisur nga fakti i trajtimit te familjeve te pastrehe, me kredi sipas mareveshjes se Qeverise Shqiptare me BKT-ne .

Konkretisht kemi kete pasqyre te regjistruar per vitin 2010 :

Viti	Kerkesa :			Ankesa		Vertetime	
	Punesim	Strehim	Nd. Financ.	Sherb. Publik	Te tjera	Si banor	Te tjera
2009	376	52	334	229	130		
2010	120	161	180	197	136	2019	232
<i>Krahasuar</i>	<i>- 256</i>	<i>+ 109</i>	<i>- 154</i>	<i>- 32</i>	<i>+ 6</i>		

- Nga sektori i protokollit jane menazhuar **1227 shkresa** te hyra dhe **1387 shkresa** te prodhuara nga administrata, sipas tabelës :

Vitet	Shkresa		vendime	Urdhera	te tjera
	Hyrje	Dalje			
2009	1335	1416	29	60	147
2010	1224	1387	77	56	302
<i>Krahasuar</i>	<i>- 111</i>	<i>- 29</i>	<i>+ 48</i>	<i>- 4</i>	<i>+ 155</i>

Si konkluzion: Renja e korespondences zyrtare ne hyrje – dalje tregon per nje pune direkte me efektive realizuar gjate vitit 2010 ndaj vitit 2009.

Disa probleme qe duhen evidentuar :

Se pari : Akoma nuk eshte krijuar tradita, qe forcat njerezore ne administrate te vleresojne detyren dhe pergjegjesine relativisht njelloj Kjo rezulton nga monitorimi i punes ne tre muajit e fundvitit 2010.

Se dyti : Ritheksojme faktin se pergjegjshmeria ne kryerjen e detyres dhe bashkerendimi ndermjet zyrave dhe sektoreve, per krijimin e nje fronti unik ne zgjidhjen e problemeve qe shqetesojne komunitetin, jo gjithnje kane efikasitetin e duhur.

Se treti : Ndonese jane bere perpjekjet per kualifikimin e punonjesve, ne te gjitha format si nga vete administrata, nga Fondacione e shoqata me aktivitte brënda dhe jashte vendit, por akoma kemi shume per te bere ne aspektin e trajnimit te punonjesve, kryesisht ata të rinj. E themi kete jo vetem per faktin se ata (nepunesit e rinj) jane per nje kohe me te avancuar, por edhe per faktin se vendit tone i ofrohen shanse te medha perfitimi nepermes projekteve qe B.E-se, ofron per vendet ne zhvillim dhe ato kandidat per BB-ne.

Se katerti: Mbase nuk eshte momenti, por e sjellim ne vemendjen e secilit se, verejtje jane dhene, per shfrytezimin e kohes fizike te punes. Ndaj rasteve te kesaj natyre nuk do jemi tolerat, por shume te prere ndaj atij qe abuzon me kohen dhe cilesine e punes.

Ndaj ketyre problemeve duke e marre ne formen e verejtjes ne kete analize, kerkojme te jete me aktive dhe me kerkuese drejtoria e Burimeve Njerezore.

INSPEKTORIATI NDERTIMOR URBANISTIK

Ka patur si objekt :

1. Mbajtjen nën kontroll të territorit të Bashkisë, në zbatim të planit rregullues të qytetit, në përputhje me legjislacionin urban;
2. Nderhyrjen në të gjitha rastet kur janë vërejtur shkelje të ligjit mbi urbanistikën, për parandalimin e ndertimeve pa leje, si dhe prishjen e çdo ndërtimi i cili bie në kundërshtim me planin rregullues të qytetit.

Krahas aspektit parandalues, në punën e këtij sektori një vend të rëndësishëm ka zënë evidentimi i ndertimeve pa leje ose me leje, por në zona të ndaluara siç është “Parku Arkeologjik”, për të cilat ka informuar INUK-n dhe Keshillin e Bashkisë.

Gjatë vitit 2010 inspektoriati ndertimor ka ushtruar kontrole, dhënë akte pezullimi dhe procesverbale, për dokumentacionin tekniko-ligjor dhe zbatimin me përpikëri të projekteve, për **70 subjekte ndertuese** si dhe janë nxjerrë **21 vendime prishje**, të cilat janë zbatuar plotësisht.

Nderhyrjet për prishje kanë qenë kryesisht në periudhën kur është filluar zbatimi i projekteve, për rikonstruksionin e infrastruktures publike. Këto ndërhyrje kanë qenë të përgjithshme dhe në kohën e duhur. Kjo ka ndikuar në rritjen e besueshmërisë dhe autoritetin e këtij organizmi.

Këto ditë janë në proces shembje 20 objekte në bllokun e banimit në bregun e Drinit dhe 8 objekte në rrugën e shkolles “Gj. Fishta”.

Ndonëse ky sektor përballë të kundërvajtësive dhe veprimtaria e tij është gjithnjë në konflikt me interesat e ndertuesve jo ligjor, në punën e tij duhet përkujdesje e veçantë, në aspektin e parandalimit të ndërtimit duke ndërhyrë me shumë forca që në fillim të punimeve, pa prituri ngritjen apo ndërtimin e plote të objektit. Kjo praktikë jo vetëm realizon koherencë në zbatim të ligjit, njëkohësisht shmang konfliktet me banorë dhe subjekte ndertuese.

POLICIA BASHKIAKE

Në përberje të së cilës janë 7 veta me një mision të rëndësishëm në Bashki, si institucion i zbatimit të akteve administrative dhe mbështetje në të gjithë praktikën ligjore, të sektoreve të tjera.

Në detyrat kryesore të realizuara nga Policisë Bashkiake kanë qenë :

- Mbeshtetje ndaj drejtorive dhe sektoreve të ndryshme të Bashkisë, për realizimin e detyrave të tyre funksionale, kryesisht drejtorinë e Tatimit taksave.
- Vendosja e rregullit në funksion të ligjit, për lirimin e hapësirave publike në qytet.
- Zbatimin e rregullave të Kodit Rrugor në aspektin e parkimit të automjeteve private në akset kryesore të qytetit. Ndaj kundërvajtësive në këtë sektor janë vendosur **110 gjoha** me vlerë **119 000** leke.
- Zgjidhjen e konflikteve të krijuara nga qytetarë të ndryshëm në blloqet e banimit etj.

Krahas ketyre detyrave nje vend te rendesishem ne punen e Policise Bashkiake ka zene mbeshtetja ndaj drejtorise Tatim Taksave, per realizimin e te ardhurave vendore dhe Inspektoriatin Ndertimor, per pezullimin e ndertimeve te paligjshme dhe shembjen e objekteve paleje, per t'i hapur rruge investimeve publike.

Por krahas angazhimeve jane verejtur mangesi dhe veshtiresi ne kryerjen e detyres nder te cilat evidentome :

1. Mangesite e ligjit, per kompetencat e policise bashkiake ne qytete si Lezhe, kryesisht ne aspektin e qarkullimit dhe mungesa e bashkepunimit me sektorin e policise se qarkullimit rrugor.
2. Mungesa e profesionalizmit dhe kultures ne kryerjen e detyres.
3. Mangesi ne bashkerendimin me struktura te tjera te Bashkise, ne mbeshtetje te kerkesave per zbatimin e akteve administrative dhe detyrimeve ligjore.

Keto dhe te tjera kane qene mangesite dhe veshtiresite qe kane patur ndikim ne punen e Policise Bashkiake. Keto mangesi jane evidentuar nga vete policia Bashkiake ne analize ne saj vjetor. E rendesishme mbetet, reflektimi ndaj mangesive te konstatuara dhe permiresimi i punes ne vitin qe sapo kemi filluar.

ZYRA E GJENDJES CIVILE:

Si funksion i deleguar me nje staf prej dy vetash ka patur si mision :

1. Organizimin e punës, për një shërbim të kulturuar, të efektshëm dhe korrekt ndaj qytetarëve që kanë nevojë për shërbimin e zyrës së gjendjes civile;
2. Mbarëvajtjen e punës në veprimatrinë e gjendjes civile me synim modernizimin gradual të shërbimeve që ofron zyra e gjendjes civile;
3. Bashkëpunimi me zyrat homologe te njesive vendore, ne funksion te detyres dhe problemeve që lindin gjatë procesit të punës;

Keto kane qene drejtimet kryesore mbi te cilet eshte mbeshtetur puna e kesaj zyre gjate vitit 2010. Ne menyre te vecante kjo zyre eshte pergjegjur kerkesave te banoreve, per dhenjen e certifikateve, ndryshimet demografike, regjistrimet e lindjeve ne afatet ligjore, ndjekja e praktikave te martesave etj.

Per t'i paraprire vitit elektoral 2011, eshte punuar me listat zgjedhore paraprake te cilat jane shpallur prane cdo qendre votimi, detyre e cila vijon edhe kete vit, deri ne zgjedhjet e 8 majit.

Nder arritjet e vitit evidentojme :

- Përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarëve.
- Pergatitja e Rregjistrimit Kombetar te zgjedhjeve dhe perballimi ne afate ligjore te gjitha fazave parazgjedhore.
- Krijimin e kushteve te punes dhe implemtimi i projektit, per leternjofitimet e reja dhe pasaportat Biometrike.
- Ndryshimet demografike te nddhura ne qytetin tone siç jane :

Vitet	Popullsia	meshkuj	femra	familje	lindje	martesa	vdekje
viti 2009	27 726	13 600	14 126	7480	209	160	101
viti 2010	28 232	13 828	14 404	7648	208	145	85
Shtesa	+ 506	+ 228	+ 278	+ 168	- 1	- 15	-16

Te nderuar pjesemarres !

Situata ekonomike e paraqitur me siper dhe angazhimi maksimal i forcave njerezore ne administraten e Bashkise, krijojne premisa te besueshme, per.....

- Ta shtrire vizionin tone ne lartesite e kerkesave te kohes, per te marre nisma te reja ambicioze, ne hartimin dhe implementimin e projekteve me rendesi zhvillimi per te ardhmen e qytetit tone.
- Per t'u vene gjithnje e me shume ne sherbim te komunitetit qytetar, ne funksion te rritjes se nivelit dhe cilesese se jetes tyre;
- Per te mundesuar hapisira te reja zhvillimi per brezin e ri i cili po rritet dhe arsimohet ne shkollat brenda dhe jashte vendit,
- Per krijimin e mundesive per nje bashkejetese qytetare te te gjitha grup moshave, perfshire edhe moshen e trete si nje detyrim i perhershem, per kontributin e dhene ne vite ne funksion te zhvillimit dhe jetes qytetare etj.

Keto, e te tjera premisa, e bëjme gjithnje me optimiste punen dhe angazhimin tone ne raport me qellimin qe i kemi vene vehtes, ne permbushjen e misionit te besuar nga votbesimi i qytetareve tane.

Si perfundim :

Siç doli nga ky material modest bashkia Lezhe gjate vitit 2010, ka patur nje vizion te qarte ne punen e saj, ndonese nuk i realizoj te gjitha detyrat sipas vullnetit.

Ne menyre te vecante eshte vleresuarmaksimalisht dhe mbetet aksiome e punes tone **“Sherbimi ndaj komunitetit lezhjan”** ne te gjitha hapesirat qe ofron ligji.

Gjithashtu theksojme se : *Realizimi i ketij misioni nuk arrihet pa patur nje lidhje korelative dhe partneritet te plote me Keshillin e Bashkise, Keshillin e Qarkut, institucionet vendore, Institucionin e Prefektit, mbeshtetjen e Qeverise dhe pushtetit te katert - Media-s.*

Si perfundim duke njohur me pergjegjesi mangesive tona te konstatuara gjate vitit 2010, do jemi shume me te vemendshem dhe kembengules ne permiresimin e dukshem te punes dhe veprimtrise se gjithshme te administrates se bashkise per vitin 2011.

Faleminderit per vemendjen.

VIKTOR TUSHAJ

Lezhe, me 09.02.2011

OJEKTIVAT KRYESORE TE VITIT 2011

a. Ne aspektin ekonomik:

1. Realizimi e plote te te *ardhurave vendore ne vleren 127.330 mije leke* per vitin 2011.
2. Vendosja e nje regjimi te forte kursimi nga sektori i finances, per mirëadministrimin e buxhetit te vitit 2011, ne *vleren prej 241 150 mije leke*.

b. Ne aspektin Urban dhe infrastrukturen Publike:

1. Përfundimi i hartimit te Planit të Përgjithshëm Rregullues te qytetit dhe miratimi i tij ne institucionet perkatese (nga KRRrT-ja e Bashkise, e Qarkut dhe KRRrTR-ja).
2. Realizimin e plote te sistemit te adresave si numertimin e banesave dhe vendosjen e tabelave sipas emertimit te rrugeve.
3. Kontrollin e plote te territorit urban te qytetit me objekt parandalimin e ndertimeve pa leje dhe jashte planit te pergjithshem urban.
4. Pergatitjen e dokumentacionit teknik dhe rregjistrimin 100 pronave publike te miratuara me V.K.M.nr 414, datë 11.07.2007 dhe VKM nr.1686, datë 24.12.2008.
5. Ndertimin e shkolles mesem te Pergjithshme.
6. Ndertimin e shkolles 9 vjeçare “Beslidhja”.
7. Sistemimin e bllokut te banimit ne bregun e lumit Drin - lagje “Beslidhja”.
8. Sistemim asfaltimin e rruges ne bllokun 11,2 ha.- lagje “Beslidhja”.
9. Sistemimin dhe asfaltimin e pjeseshem te akseve rrugore dhe blloqeve te banimit ne lagje “Nene Tereza”, “Beslidhja”, “Gurra” dhe “Spitalit”.

c. Ne aspektin e sherbimeve publike dhe perkujdesjes sociale:

1. Permiresimin e metodologjise se pastrimit qytetit, nepermes mekanizimit te procesit te pastrimit.
2. Shtrirjen ne 50 perqind te qytetit, zbatimin e projektit per - “menaxhimin e diferencuar te mbetjeve urbane”.
3. Inplementimin e dy projekteve ne bashkepunim me donator te Huaj (dldp & bells), per funksion te projektit, per menaxhimin e diferencuar te mbetjeve urbane dhe riciklimin e pjeseshem te tyre si : plastikën, qelqin dhe letren.
4. Shtimin e zonave te gjelberta dhe permiresimi i plote i tyre ne gjithe hapësiren e qytetit, ne stinen e pranveres.
5. Riorganizimin e pritjes se komunitetit, duke vene ne zbatim praktiken e “Zyres me Një Ndalese”, ne sherbim te permiresimit te maredhenjeve me publikun.
6. Kushtezimin e ndihmes ekonomike, nepermes “Punes dhe sherbimit ne komunitet”, duke perfshire rreth 250 familje ne projekte te tilla.
7. Gjetjen e donatoreve, per trajtimin e 100 familjeve ne nevojë me ndihma ushqimore, per periudhen gjithëvjete.

d. Ne aspektin perspektiv dhe komunikimin me publikun:

1. Evidentimin e indikatorëve të zhvillimit dhe ripunimin e "Strategjisë së Zhvillimit afatmës të qytetit".
2. Hartimi i "Strategjisë së zhvillimit të Turizmit"
3. Nepermes promovimit të vlerave kulturore, historike dhe arkeologjike të qytetit të Lezhës, të rrisim interesin e vizitorëve, për një nivel më cilësor dhe shtrirje gjithëvjetore të turizmit kulturor.
4. Rivlerësimin e interesave të donatorëve dhe biznesmënëve të huaj, për gjetjenë e zhvilluesve, për fillimin e punës në ndërtimin e "Parkut Industrial" të qytetit.
5. Përmirësimin e praktikës së informacionit dhe modelin e Buletinit informativ, gjithnjë në funksion të informimit koherent të publikut.

BASHKIA LEZHE

Janar 2011